



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 382/24 Dt. 25.06.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e rritjes së numrit të bursave studentore për vitin akademik 2023/2024

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës për lejimin e rritjes (shtimit) së numrit të bursave studentore për vitin akademik 2023/2024 edhe për 20 bursa.
2. Të drejtë për marrje të bursës do të kenë vetëm studentët nga Komuna e Prizrenit.
3. Shuma e përgjithshme që lejohet për këtë qëllim, është në vlerë prej 14.000 € (katërmëdhjetë mijë euro) për bursa të studentëve përkatësisht 700 € (shtatëqind euro) për një student.
4. Shuma e lejuar, si në pikën 3 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës.
5. Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Arkivës së Kryetarit.

